<sup>7</sup> Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Shtojca 9/1

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik ]

#### DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ me cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 10

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

## 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomik, duhet të dorëzohen:

- Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- Prokura e posacme.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës Ekonomike sipas Shtojces 3; (do paraqitet ne fazen e dyte)*
- b. *Deklarate për paraqitje Oferte të Pavarur sipas shtojces 4; (do paraqitet ne fazen e dyte)*
- c. *Sigurim oferte 2 %, sipas Shtojcës 5; (do paraqitet ne fazen e dyte)*
- d. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 8;*
- ç. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 9/1:*
- e. *Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

### 3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 10.

#### 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate dy viteve te fundit (2018, 2019) e cila duhet të jetë sa vlera e fondit limit, perkatesisht: 3,672,590 (tremilion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

b) Operatori Ekonomike duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit ushtrimore (2018, 2019) të paraqitura në autoritetet përkatëse.

c) Taksat vendore: Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin, 2020 sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësia Administrative ose Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKR).

#### 3.3 Kapaciteti teknik:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar për shërbimet e mëparshme nuk duhet të jetë me e vogel se 40 % e e fondit limit, perkatesisht: 1.469.036 (një milion e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tridhjetë e gjashtë) leke pa tvsh, e realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit.

Per kete Operatori ekonomik duhet te paraqese, kontrate, vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen, kontratat dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

4. Operatori ekonomik duhet te paraqese *Liçense profesionale* per “Mbikqyrje dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi”, e vlefshme, ku te perfshihen kategorite e meposhtme, (sipas modelit të lëshuar nga MPPT ose nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e Mbikqyrjes dhe Kolaudim Punimesh Zbatimi):



## PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- N.P – 1 Punime gjurmimi në tokë
- N.P – 2 Ndertime civile dhe Industriale
- N.P – 7 Ujesjelles, kanalizime, vepra kullimi dhe vaditje
- N.P – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

## PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- N.S - 1 Punime për prishjen e ndertesave
- N.S - 2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajta e tyre
- N.S - 3 Impiante ngritese transportuese
- N.S – 4 Punime rifiniture të muratës dhe të lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndertuese
- N.S - 12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike dhe telefonike, radiotelefoni TV
- N.S - 18 A Punime topogjeodezike

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

*(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit ose pranë Institucionit të Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës), në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).*

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik, të përfshirë në licensën e shoqërisë ose të pajisur me licensë individuale përkatëse si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier gjeodet /Topograf/Markshajder/Gjeomatik
- 1 (nje) Inxhinier elektrik
- 1 (një) Inxhinier mjedisi

*Per stafin e mesiperm inxhinierik duhet te paraqiten kontrate pune (e vlefshme) dhe diplomë përkatëse si dhe te figurojne ne Listpagesat e shoqerise për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.*

6. Një punësim mesatar i të paktën 8 (tëtë) punonjësve, për periudhën Qershor 2020–Nentor 2020 të vërtetuar me;

- a. Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për periudhën Qershor 2020–Nentor 2020 shoqëruar me listëpagesat sipas formatit që kërkohet nga legjislacionin tatimor.

7. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001-2015 (e vlefshme). lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
8. Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 14001-2015 (e vlefshme). lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatë OHSAS 18001-2007 / ISO 45001-2018 (e vlefshme) lëshuar nga institucione të akredituara për këtë qëllim me objekt: supervizion rrugësh dhe ndërtesa civile. ((Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).
10. Operatori ekonomik duhet paraqesë me anë të një deklaratë listën e personelit kryesor të nevojshëm për të zbatuar objektin dhe CV të shoqërisë për punët e realizuara gjatë aktivitetit të saj.
11. Operatoret ekonomike ne pergatitjen e ofertes se tyre gjate fazes se II duhet ti referohen VKM Nr.354,date 11.05.2016”Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit,projektim,mbikeqyrje dhe kolaudim”, si dhe ne mbeshtetje te udhezimit te Agjencise Prokurimit Publik date 25.07.2017, Prot. 5585 ”Rekomandim mbi menyren e percaktimit te tarifave minimale te specifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.354,date 11.05.2016” “Per miratimin e manualit te tarifave per sherbime ne planifikimin te territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

*Mospergatitja e ofertes sipas bazes ligjore te siperpermendur perben shkak per skualifikim.*

*Shënim:*

*Operatori ekonomik duhet te paraqesë metodologjinë e punës lidhur me Kohën e zbatimit të kontratës, ku “duhet të tregojë aftësinë për t’i transformuar kërkesat e specifikimeve teknike, preventivin dhe kostot në plan pune konkrete, me qëllim për të realizuar punimet sipas afatit”, si dhe metodologjinë e punës lidhur me Cilësinë “Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj si për shembull por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të zbatimit, termave të referencës dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi”.*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 11

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike të objektit të prokurimit të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e

ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

**KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 12

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 13

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

#### SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Mbikqyrje e punimeve për objektin: “Ndërtim dhe rikonstruksion të infrastrukturës publike (godina), në zonat e reja të shpallura për zhvillim në Bashkinë Tiranë”, i ndarë si më poshtë vijon :

- Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim shkolle dhe godinë për shërbime komunitare - Vaqarr
- Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim kopësht & çerdhe dhe qendër shëndetësore – Ndroq”
- Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Ndërtim godinë për shërbime komunitare -Zall Herr”

Afatet e ekzekutimit: Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër do të jetë 24 muaj. Kohëzgjatja e kontratës/kontratave do të jetë deri në 12 (dymbëdhjetë) muaj nga momenti i lidhjes ose me afat me të shkurtër në varësi të veçantisë së objektit .

Shtojca 14

*( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## TERMAT E REFERENCËS

Afati i realizimit të supervizionit të punimeve do të jetë i njëjtë me afatin e realizimit të punimeve nga shoqëria ndërtimore e cila do të zbatojë punimet si dhe inspektimet gjatë periudhës 2 vjeçare të garancisë kur kërkohet nga investitori.

## 1. Objektivi kryesor i Mbikqyresit

1.1 Mbikqyresi i punimeve të zbatimit të objektit ka për qëllim të kontrollojë dhe të ndjeke mbarevajtjen e gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, si dhe destinacionin e objektit, duke patur parasysh afatin kohor të përcaktuar për kryerjen e punimeve dhe vlerën e kontratës.

## 2. Detyrat, përgjegjësitë dhe të drejtat e Mbikqyresit

2.1 Në realizimin e objektivave për zbatimin e punimeve të projektit, Mbikqyresi menjëherë mbas lidhjes së kontratës duhet:

- Të mbikqyrë kontratën e zbatimit të punimeve në emër të Autoritetit përgjegjës dhe të kryejë të gjitha detyrimet sipas kontratës së nënshkruar dhe legjislacionit në fuqi.
- Të njihet në detaj me projekt-zbatimin dhe specifikimet teknike të objektit, të hartojë programin e kontrollit për zbatimin e projektit dhe cilesinë e punimeve, si dhe zbatimin të VNM në baza të standardeve të përcaktuara me ligj (sipas Ligjit Nr. 8402, dt. 10.09.1998, UKM Nr. 3, dt. 15.02.2011, UKM Nr. 1, dt. 22.02.2005, UKM Nr. 2, dt. 13.05.2005). Të paraqesë pranë Autoritetit përgjegjës stafin e tij mbikqyrës, siç është përcaktuar në kërkesat e stafit kryesor.
- Në baza të volumit të punimeve dhe vlerës së kontratës Mbikqyresi i punimeve duhet të jetë rezident me kohë pune të plote në objekt, ndërsa stafi tjetër mbikqyrës mund të jetë rezident në objekt me kohë të pjesshme.

2.2 Mbikqyresi i punimeve dhe stafi i tij kontraktohet nga Autoriteti Përgjegjës, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjellta, kushtet e punës, shpërblimin, etj.

2.3 Mbikqyresi ve në dijeni Autoritetin Përgjegjës për nenkontraktoret e mundshme që zgjedh Sipermaresi (Zbatuesi i Punimeve) në përputhje me kontratën e zbatimit të punimeve.

2.4 Mbikqyresi në fillim të punimeve në objekt, merr kontakt me organet qeverisëse, në juridiksionin e të cilit ndodhet zona ku kryhet ky objekt, dhe informon personat kryesorë përgjegjës për ndërtimin e këtij objekti, në përputhje me legjislacionin në fuqi (Neni 9, ligji Nr. 8402, dt. 10.09.1998).

## 3. Detyrat e mbikqyresit

3.1 Mbikqyresi ka për detyrë:

- Te beje verifikimin e te gjithë dokumentacionit perkates te liçensave, te autorizimeve dhe te lejeve, te cilat sipas dispozitave ne fuqi duhet te merren para fillimit te punimeve.
  - Te beje verifikimin e sheshit te ndertimit, nese eshte i lire dhe gati per te filluar punimet.
  - Te njihet me hollesi me kontraten e zbatimit te punimeve dhe te gjithë akteve administrative qe lidhen me te, si dhe njohjen e te gjitha ndryshimeve te mundshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.
  - Te kontrolloje vendosjen e tabelës se identifikimit te objektit me te dhenat e meposhtme:
    - Emertimi i objektit:
    - Data e marrjes se lejes se ndertimit:
    - Investitori:
    - Projektuesi:
    - Sipermarresi dhe drejtuesi teknik:
    - Mbikqyresi:
    - Afati i ndertimit te objektit:
    - Vlera e objektit:
- 3.2 Mbikqyresi menjehere mbas lidhjes se kontrates duhet:
- Te marre masat e duhura per sigurine e objektit duke kontrolluar vendosjen ne objekt te tabelave perkatese sinjalizuese, treguese e te sigurise, shiritave, fenereve, etj.
  - Mbas verifikimit te dokumentacionit duhet te dorezoje prane Autoritetit Përgjegjës te gjithë dokumentacionin, si dhe shkresen per fillimin e punimeve ku te perfshihen:
    - Stafi i Sipermarresit
    - Makinerite qe do perdoren per ndertimin e objektit
    - Pikat e marrjes se lendeve te para inerte
    - Zonat e ngritjes se kantjerit
  - Para fillimit te punimeve verifikon te gjitha pajisjet dhe makinerite e Sipermaresit, per te pare nese ato i pergjigjen kushteve te kontrates se zbatimit.
  - Te kontrolloje zbatimin e projektit duke u bazuar ne projekt zbatimin dhe specifikimet teknike dhe te propozoje modifikimet, plotesimet dhe mosperputhjet, nese ka, dhe ti propozoje Autoritetit Përgjegjës zgjidhjet konkrete.
  - Te ndjeke ne menyre te vazhdueshme e te kualifikuar te gjitha proçeset e punimeve dhe dokumentacione qe duhen te mbahen gjate zbatimit te punimeve, miratimin e analizave te veçanta, duke dhene udhezime, porosi e urdhera per zbatimin me perpikmeri e ne kohe te projektit, te kushteve teknike te projektimit dhe zbatimit te dispozitave perkatese te kontratave.
  - Te kontrolloje ne menyre korekte dhe te vazhdueshme piketimin e objektit dhe çdo material qe vendoset ne veper, menyren e vendosjes se tij dhe cilesine e tij.
  - Per çdo punim te maskuar te beje (fotografimin ose regjistrim e tij dhe te mbaje proces-verbal te firmosur prej tij dhe sipermaresit.
  - Ne çdo fund dite pune te kontrolloje ditarin e punimeve dhe te firmose ate.
  - Te kontrolloje librezen e masave, e cila verteton volumin e punimeve dhe ta miratoje ate.
  - Te kontrolloje çertifikatat e cilesise se materialeve dhe te jape miratimin per vendosjen e tyre ne objekt.
  - Gjate zbatimit te projektit, i jep udhezime me shkrim Sipermaresit, sa here qe e sheh te nevojshme dhe Sipermaresi eshte i detyruar t'i zbatoje ato. Ky i fundit, ka te drejte te beje me shkrim verejtjet e tij lidhur me udhezimet dhe urdherat e marra.

- Per çdo rast, qe gjate zbatimit te punimeve lind nevoja e ndryshimeve ne projektin dhe preventivin e parashikuar, Mbikqyresi i punimeve duhet t'i paraqese Autoritetit Përgjegjës nje relacion te plote teknik, shoqeruar me skicat perkatese ku argumentohet ndryshimi. Ndryshimi ne object, gjate zbatimit te punimeve, do te behet vetem pas miratimit nga Autoriteti Kontra Përgjegjës ktor.
  - Ne çdo fund muaji, Mbikqyresi ka per detyre te paraqese prane Autoritetit Përgjegjës raport mujor te punimeve. Ne kete raport duhet te jepet nje tabllo e qarte e progresit te punimeve dhe te pagesave te kryera, realizimi i punimeve ne vlere dhe %, afati kohor, realizimi i financimit.
  - Korrespondenca ndermjet paleve behet gjithnje ne menyre zyrtare, me shkrim.
- 3.3 Raporti Mujor do te permbaje lenden e meposhtme:

- Hyrje
- Informacion i pergjithshem
- Te pergjithshme
- Qellimi i punimeve
- Mbikqyrja e punimeve ndertimore
- Personeli i siguruar nga Mbikqyresi
- Stafi i nevojshem ne perputhje me kontraten e zbatimit te punimeve
- Stafi aktual
- Koheqendrimi ne objekt per secilin pjesetar te stafit mbikqyres
- Raportimi
- Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- Pershkrimi i Projektit
- Karakteristikat teknike dhe te dhena per objektin specifik
- Organizimi i Sipermaresit
- Sipermaresi
- Stafi prezent
- Mjete dhe makineri
- Koheqendrimi ne objekt
- Progresi Mujor
- Pershkrim te Punimeve qe jane kryer gjate muajit (sipas zerave dhe piketave)
- Fotografi te proçeseve te punimeve te kryera
- Fotografi te punimeve te maskuara per çdo punim te padukshem
- Grafiku i ecurise se punimeve
- Te aprovuara
- Te kryera
- Volumet Progressive te Punimeve Mujore
- Punimet e Aprovuara
- Çertifikatat e cilesise dhe Provat Laboratorike<sup>8</sup>,
- Libreza e Masave
- Punimet e Kryera por te pa aprovuara
- Situacionet mujore

---

<sup>8</sup> Shënim Operatori Ekonomik duhet të paraqese dokumentacion që tregon se disponon apo ka një marrëveshje shërbimi/furnizimi me një laborator të akredituara për testimin e materialeve.

- Matjet topografike
- Korrespondenca
- Proces-Verbale
- Urdhera, Udhezime, Njoftime
- Ndryshime ne Projekt - Preventiv nese ka (te aprovuara nga Autoriteti Përgjegjës)
- Moti (kalendarik)
- Problemet qe kane dale
- Teknike
- Sociale
- Konkluzione

#### 4. Përgjegjësia e Mbikqyresit

##### 4.1 Ne fillim te punimeve Mbikqyresi mban dhe ka përgjegjesi per dokumentacionin e meposhtem:

- Vendimin e sheshit e ndertimit dhe lejen origjinale zhvillimore.
- Projekt-zbatimin e firmosur nga projektuesi dhe investitori sebashku me specifikimet teknike.
- Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik te bazamentit ku do te kryhen punimet.
- Dokumentacionin per realizimin e punimeve te objektit sipas projektit, kushteve teknike te zbatimit ne fuqi dhe specifikimeve teknike.
- Saktesine e vertetesine e dokumenteve, volumet dhe cilesine e punimeve te ndertimit.
- Per realizimin me korrektesi te kontrates se nenshkruar midis Sipermaresit dhe Autoritetit Kontraktor, per realizimin e te gjitha fazave te zbatimit te punimeve, respektimit te afatit te dorezimit si dhe te kostos se objektit.
- Asnje punim nuk do te mbulohet, maskohet apo betonohet pa miratimin e Mbikqyresit. Sipermaresi duhet te njoftoje Mbikqyresin kur eshte gati per t'u ekzaminuar prej tij.
- Ruajtjen e te gjitha dokumentacionit dhe korespondencen me Autoritetin Kontraktor, urdherat e ndryshme qe ai ka dhene gjate zbatimit te kontrates, kundershite dhe kontradiktat e lindura gjate punes, nderprerjet e punimeve dhe shkaqet qe i kane diktuar keto nderprerje, relacionet teknike te kerkuara ose te paraqitura gjate zbatimit, si dhe te gjitha rrethanat e nevojshme per te dhene kuadrin e plote te te gjitha fazave te zbatimit te punimeve.
- Ne rast se gjate zbatimit te kontrates kemi ndërrim te Mbikqyresit, per dorezimin e gjithë dokumentacionit qe disponon Mbikqyresi, i gjithë dokumentacioni dorezohet me proces-verbal ku shenohen dhe shkaqet e ketij nderrimi.

#### 5. Te drejtat e Mbikqyresit

##### 5.1 Mbikqyresi ka te drejte:

- Te kerkoje largimin nga puna te Drejtuesit te Kantierit ose te punetoreve te veçante per mosbindje, paaftesi ose pakujdesi te rende.
- Te mos pranoje drejtues teknik, manovrator, punetor, etj, nqs keta nuk plotesojne kushtet per te kryer detyren e caktuar.
- Te pezulloje punimet kur sheh se ne objekt nuk jane marre masat e duhura per te siguruar punimet dhe trafikun.
- Te kerkoje certifikatat e cilesise se pajisjeve qe kryejne testet e materiale.



- Te kerkoje dhe te asistojë ne kryerjen e provave te materialeve, per te verifikuar cilesine e tyre. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Te mos lejoje vendosjen ne veper te materialeve qe nuk plotesojne kushtet e cilesise dhe ti zevendesojë ato me materiale te tjera nga Sipermarresi me shpenzimet e tij.
- Te kerkoje per te gjitha makinerite qe punojne ne veper dokumentacionet teknike per te siguruar nje ecuri punimesh te sigurta dhe cilesore.
- Te mos lejoje perdorimin e makinerive dhe pajisjeve te ndryshme nqs ato jane jashte kushteve teknike.
- Ne rast se materialet dhe pajisjet e perdorura nuk miratohen nga Mbikqyresi keto duhet te dokumentohen me proces-verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik, ku te argumentohen shmangiet e palejuara referuar standardeve te percaktuara ne specifikimet teknike te projekt-zbatimit.
- Te kerkoje kryerjen e provave shtese per materialet e vendosura ne objekt, kur keto nuk jane kryer ne masen sipas vellimeve te realizuara dhe pjese se lendes se pare te furnizuar per te verifikuar cilesine. Shpenzimet per keto prova jane ne ngarkim te Sipermaresit.
- Kur Mbikqyresi i punimeve mendon se ka demtime ne konstruksion, kerkon te behen verifikimet perkatese. Kur verifikimet i japin te drejte Mbikqyresit, shpenzimet jane ne ngarkim te Sipermaresit. Ne rast te kundert, Sipermaresi ka te drejte te kerkoje shlyerjen e shpenzimeve.
- Mbikqyresi i punimeve urdheron Sipermaresin te prishe dhe te ribeje me shpenzimet e tij, punime te bera jo me cilesine e parashikuar ne projekt dhe specifikimet teknike.
- Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet, per ekzekutim teknik te gabuar ose paaftesi teknike zbatimi, per çdo rast, me miratimin e Autoritetit Përgjegjës per aq kohe sa ai e konsideron te arsyeshme. Ne kete rast, sipas fajit, Mbikqyresi se bashku me Autoritetit Përgjegjës dhe Sipermarresin percaktojne zgjatjen ose jo te afatit dhe ndryshimin e shpenzimeve.
- Te kontrolloje dhe autorizojë perdorimin e fondit rezerve te preventivuar dhe i raporton periodikisht Autoritetit Përgjegjës per gjendjen e tij. Ne rast se Autoriteti Përgjegjës ka verejtje e njofton Sipermarresin dhe problemi zgjidhet midis tyre.
- Per çdo ndryshim te mundshem ne objekt, Mbikqyresi i punimeve ve ne dijeni Autoritetin Përgjegjës.

#### 5.2 Ne perfundim te punimeve Mbikqyresi:

- Merr me shkrim njoftimin per perfundimin e punimeve dhe verteton ne proces-verbal daten e perfundimit te tyre sipas projektit, te ndryshimeve te urdheruara e te kushteve te kontrates dhe brenda 30 diteve merr prej Përgjegjës it dokumentacionin perkates.
- Sipas legjislacionit ne fuqi dorezon prane Autoritetit Përgjegjës te gjithë dokumentacionin perkates per te cilin mban pergjegjesi te plote ne plotesimin, saktesine dhe vertetesine e tij.

#### 5.3 Ky dokumentacion duhet te permbaje:

- Proçes-verbalin e dorezimit te sheshit te ndertimit
- Proçes-verbalin per fillimin e punimeve
- Kontraten e Sipermarrrjes
- Kontraten e Mbikqyrjes
- Projekt organizimin e punimeve
- Projektin teknik te zbatimit
- Projektin e ndryshuar (nese ka) shoqeruar me korrespondencen, skicat perkatese

- dhe miratimet e nevojshme
  - Preventivin fitues
  - Preventivin e ndryshuar (nese ka zerat te rinj te punimeve, negocimin e tyre)
  - Grafikun e punimeve
  - Specifikimet teknike
  - Azhornimin para fillimit te punimeve dhe piketimi
  - Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinjerik per punime te paparashikuara
  - Dokumentacionin fotografik apo video regjistruesi per punimet e padukshme
  - Proçes-verbalet e çdo punimi te maskuar te firmosur nga drejtuesi teknik dhe Mbikqyresi te shoqeruar me fotografi
  - Ditarin e objektit ku te pasqyrohen dhe ndryshimet e urdheruara nga Mbikeqyresi
  - Librezen e masave
  - Shkresen e Mbikqyresit per investitorin ku raporton perdorimin e fondit rezerve, shoqeruar me dokumentacionin perkates
  - Proçes-verbalin e perdorimit te fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikeqyresi
  - Preventivin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Situacionin e fondit rezerve te firmosur nga Sipermarresi (drejtuesi teknik) dhe Mbikqyresi
  - Çertifikatat e cilesise se materialeve
  - Miratimin e materialeve te perdorura nga Mbikqyresi
  - Situacionet pjesore dhe situacioni perfundimtar
  - Regjistrin e kontabilitetit
  - Deklaraten teknike te Sipermarresit te firmosur nga Sipermarresi dhe drejtuesi teknik
  - Njoftimin e sipermarresit per perfundimin e punimeve
  - Proçes-verbalin e perfundimit te punimeve te firmosur nga Sipermarresi dhe Mbikqyresi, se bashku me matjet faktike te objektit te ndertuar
  - Relacionin perfundimtar te Mbikqyresit
- 5.4 I gjithë dokumentacioni duhet te kete miratimin e Mbikqyresit. Ky dokumentacion pergatitet e dorezohet ne 3 (tre) kopje.
- 5.5 Nje kopje e te gjithë dokumentacionit dorezohet prane grupit te kolaudimit qe ngrihet brenda 30 diteve nga perfundimi i objektit. Te gjithë dokumentat qe dorezohen prane grupit te kolaudimit duhet te jene origjinale.
- 5.6 Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne Kolaudimin e objektit dhe i pergjigjet grupit te kolaudimit per te gjithë dokumentacionin e nevojshem gjate kolaudimit te objektit dhe firmos. Pas perfundimit te kolaudimit, Mbikeqyresi i punimeve mbeshtetur ne kontraten dhe ne dokumentacionin tjeter, percakton vleren perfundimtare te objektit, e cila i behet e ditur Sipermaresit dhe i jepet per te likuiduar Autoritetit Përgjegjës.
6. Kohezgjatja e sherbimit te Mbikqyrjes
- 6.1 Sherbimi i mbikqyrjes zgjat per gjithë periudhen e zbatimit te punimeve.
- 6.2 Autoriteti Përgjegjës ka te drejte te kerkoje largimin e Mbikqyresit kur verteton mangesi serioze ne veprimtarine e tij si:
- Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara
  - Nderprerje e paarsyeshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre

- Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlere mbi ato te preventivuara, tolerim te materialeve jashte cilesise se kerkuar, tolerim te punimeve jo me cilesine e kerkuar, tolerim te pajisjeve jashte kushteve teknike
- Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore, Autoriteti Përgjegjës ka te drejte te urdheroje Mbikqyresin e punimeve per nderprerjen e punes deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e gjendjes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundervajtje administrative, vendosen sanksione ne baze te legjislacionit ne fuqi.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në territorin e Bashkisë Tiranë.

Shtojca 15

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>9</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

---

<sup>9</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme [*shënoni kutinë e duhur*]:

---



---



---



---



---



---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt  
< Emri >

Shtojca 16

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_

*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË  
MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 1. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

- |                                 |                        |
|---------------------------------|------------------------|
| 2. _____                        | _____                  |
| <i>Emri i plotë i shoqërisë</i> | <i>numri i NIPT-it</i> |

Perkatësisht për arsye të mëposhtme:

---



---



---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
 (me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it* \_\_\_\_\_

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
 (me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
 (nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

#### KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES

Shërbimet – Procedura e Kufizuar

Neni 1 Qëllimi

- 1.6 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e prokuruar me anë të procedurës së kufizuar.
- 1.7 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.8 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.9 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

1.10 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojë mbi KPK.

#### Neni 2 Përkufizime

2.23 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.24 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.25 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.26 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.27 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.

2.28 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

2.29 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

2.30 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

#### Neni 3 Hartimi i Kontratës

3.3 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.4 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

#### Neni 4 Praktikant Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.4 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.5 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.6 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 5 Informacioni Konfidencial

5.3 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.4 Kontraktuesi mund t’i japë nënkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

#### Neni 6 Prona Intelektuale

6.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruar nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.



- 6.6 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.7 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
- 6.8 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

#### Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

- 7.5 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- 7.6 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.
- 7.7 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.
- 7.8 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

- 8.3 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.
- 8.4 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.
- 8.5 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

#### Neni 9 Specifikime dhe Skicime

- 9.2 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marrë parasysh standartet më të fundit.
- 9.3 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjësore përpara i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

#### Neni 10 Lejet dhe Liçensat

